



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më / / 2018

V E N D I M

Nr. 238 , Datë 27 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.178, datë 19.11.2018, të Shoqatës “Ilinden¹”, kundër z.K. G/nënkryetar i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve (KSHM), me objekt pretendimin për diskriminim “për shkak të etnisë²”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nga parashtrimet e sjella nga Shoqata “Ilinden”, përfaqësuar nga z.N. Gj, në cilësinë e kryetarit të saj, pretendohet se z.K. G, nënkryetar i KSHM-së, në profilin e tij të facebook-ut, ka bërë një shkrim fyes për dinjitetin e minoritetit maqedonas në Republikën e Shqipërisë. Subjekti ankues citon se, z.K. G ka përdorur terma dhe emërtime të ndryshme për Republikën e Maqedonisë dhe i konsideron fyese për dinjitetin e minoritetit maqedonas që jeton e banon në territorin e Republikës së Shqipërisë. Z.Gj ka depozituar në cilësi prove, një printim të shkrimit të datës 14.11.2018, marrë nga faqja personale e facebookut të z.K. G, i cili ka cituar shprehimisht: “*Me 21 Nëntor 2018, ceremoni e thjeshtë por historike! Zhvillohet ora e parë e mësimit në gjuhën Armane-Vllahe pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Kushdo që është i interesuar është i lirë të*

¹ Shoqata “Ilinden”, është Organizatë Jo Fitimprurëse, dhe është regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.2473, datë 06.02.2009.

² Si pjesë e minoritetit kombëtar maqedonas në Republikën e Shqipërisë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

vijë dhe të regjistrohet goftë edhe atë ditë në orën 16:00. Janë të mirëpritur të gjithë dashamirësit vllahë ose jo, të marrin pjesë në këtë ngjarje unike në historinë e këtij komuniteti në Shqipëri. Atë ditë, kemi nevojë vetëm për buzëqeshje, gëzim dhe ndjenjën e të qenit së bashku. Na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre miq nga Ballkani dhe Europa. Këtu në foto është libri bazë i përdorur në Republikën e Makedonisë së Veriut në nivelin universitar. Ky është libri që do të përdoret edhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për Gjuhën Armane-Vllahe, i miratuar edhe nga Ministria e Arsimit të Makedonisë së Veriut dhe i propozuar nga shoqatat armane të atij vendi. Teksti është ndërtuar në bazë të rezultateve të dy kongreseve të fundit për drejtëshkrimin e Gjuhës Vllahe në Manastir dhe Fraiburg...!”.

Në përfundim të ankesës, përfaqësuesi i shoqatës “Ilinden” ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: “Z.K. G të bëjë korigjimin e tekstit dhe mos t’i përsërisë prapë këto emërtime dhe terma”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcakton se “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”. Pra siç shihet etnia gëzon mbrojtje të veçantë nga sjelljet diskriminuese apo personat që e nxisin atë, pavarësisht se kush është subjekti që mban këtë sjellje.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Për sa më lart, për të vijuar me verifikimin e fakteve të pretenduara nga subjekti ankues, lidhur me diskriminimin e minoritetit maqedonas në Republikën e Shqipërisë përmes termave të përdorur nga z.K. G në shkrimin e tij në profilin personal të facebook-ut të tij, subjekti ankues i referohet një shkrimi të datës 14 Nëntor 2018.

Ndërkohë theksojmë që ankesa është paraqitur pranë Zyrës së KMD-së me datë 19.11.2018. Komisioneri, në të njëjtën datë në të cilën është paraqitur ankesa pranë Zyrës së tij, verifikoi sa më sipër pretendohet nga subjekti ankues dhe konstatoi se, shkrimi të cilit i referohet z.Gj, mban po të njëjtën datë, 14 Nëntor 2018 (ora 23:12) dhe shprehimisht citon se: “Me 21 Nëntor 2018, ceremoni e thjeshtë por historike! Zhvillohet ora e parë e mësimit në gjuhën Armane-Vllahe

pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Kushdo që është i interesuar është i lirë të vijë dhe të regjistrohet qoftë edhe atë ditë në orën 16:00. Janë të mirëpritur të gjithë dashamirësit vllahë ose jo, të marrin pjesë në këtë ngjarje unike në historinë e këtij komuniteti në Shqipëri. Atë ditë, kemi nevojë vetëm për buzëqeshje, gëzim dhe ndjenjën e të qenit së bashku. Na nderojnë me pjesëmarrjen e tyre miq nga Ballkani dhe Europa. Këtu në foto është libri bazë i përdorur në Republikën e Makedonisë (FIROM në nivelin universitar. Ky është libri që do të përdoret edhe në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për Gjuhën Armane-Vllahe, i miratuar edhe nga Ministria e Arsimit të Makedonisë (FIROM) dhe i propozuar nga shoqatat armane të atij vendi. Teksti është ndërtuar në bazë të rezultateve të dy kongreseve të fundit për drejtëshkrimin e Gjuhës Vllahe në Manastir dhe Fraiburg...!”

Nga verifikimi rezultoi se vërtet z.K. G, (referuar materialit të printuar të shkrimit në profilin e tij të facebook-ut, sjellë nga ankuesi) në po këtë datë e ka përdorur termin Makedonia e Veriut, por në po të njëjtën datë (referuar verifikimit të faqes së tij të facebookut), me 14 Nëntor 2018, ora 23:12, është bërë prej tij korigjimi i termin Makedonia e Veriut me termin Firom, duke lënë të nënkuptohet se e kishte vetëkorigjuar.

Komisioneri është i mendimit se, jemi në kushtet kur subjekti kundër të cilit është paraqitur ka reaguar në mënyrë të menjëherëshme për termin e përdorur prej tij, duke e korigjuar atë, gjë që përmbush edhe kërkesën e subjektit ankues pranë KMD-së.

Theksojmë se, Komisioneri ka patur dhe ka vazhdimisht në vëmendjen e vet, faktin që përdorimi i medias së shkruar për të bërë publike qëndrime verbale, opinione apo veprime konkrete të personave të caktuar publikë apo subjekteve të ndryshme politike, të jetë i kujdesshëm dhe të mos ndikojë negativisht në përcjelljen e këtyre qëndrimeve që të mos kuptohen si deklarata fyese ndaj asnjë komuniteti.

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin3, pika 1, sanksionon: “Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Mirëpo, sjellja e subjektit ndaj të cilit është bërë ankesa nuk reflekton dukshëm një qëndrim të qëllimitë diskriminues ndaj komunitetit maqedonas në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që të cënonte parimin e mosdiskriminimit, në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Sjelljet diskriminuese përmes nxitjes së urrejtjes jo gjithmonë shfaqen përmes thirrjeve për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera përmes fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për

autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.

Për sa më lart, Komisioneri, vlerëson se nuk jemi në rrethanat kur subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa ka konsumuar një sjellje diskriminuese përmes gjuhës së urrejtjes, apo të ketë dashur të nxitë urrejtje përmes përdorimit të kësaj gjuhe. Ai ka vetëkorrigjuar termin e përdorur, nga Makedonia e Veriut në termin e njohur ndërkombëtarisht (deri më tani) *Firom*⁴.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa ç), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa e shoqatës “Ilinden”, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, neni 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është haptazi e pabazuar në dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime

Shkaku: Etnia

⁴ (Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së mëparshme, me nr.22/2018 të Shoqatës “Ilinden”) Referuar shkresës më nr. nr. 7270 prot., datë 30.04.2018, Ministria e Punëve të Jashtme informoi KMD-në se: “...*Republika e Shqipërisë, në marrëdhëniet dypalëshe e njej me emërtimin “Republika e Maqedonisë”, ndërsa në marrëdhëniet shumëpalëshe në organizatat ndërkombëtare e njej me emërtimin “FIROM”.*”